



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1144/1 prot.

Tiranë më/3 .6 .2022

Lënda: Dhënie mendimi për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për të dhënat që mban regjistri elektronik i përkthyesve zyrtar dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara”

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 3250/1 prot., datë 06.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1144 prot., datë 08.06.2022, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për të dhënat që mban regjistri elektronik i përkthyesve zyrtar dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara”, (në vijim “Regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë”), më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, vlerësojmë se, ndryshimet të cilat duhet të reflektohen në aktin nënligjor në fjalë janë si vijon:

Fillimisht, lidhur me nenin 10 të projektvendimit, i cili përcakton se, Regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë ndërvepron me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, Zyra e Komisionerit ju bën me dije se, Udhëzimi i përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” (në vijim, “Udhëzimi”) i Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në pikën 1 të tij përcakton se:

“Institucionet, organet, personat juridikë publikë (kontrolluesit publikë) mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltar dhe

nga aktet e gjendjes civile, nëse kjo e drejtë ju njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin përcaktohet në aneksin 1 të këtij Udhëzimi”.

Nga verifikimi i përmbajtjes së Aneksit 1, të këtij Udhëzimi rezulton se, Ministria e Drejtësisë nuk renditet në listën e institucioneve të cilat marrin informacion nga Regjistri i Gjendjes Civile.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit sugjeron se, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij Udhëzimi, për marrjen e informacionit në rrugë elektronike, kriteret dhe kushtet konkrete duhet të përcaktohen me marrëveshje dypalëshe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe kontrolluesit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit specifik dhe ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar (në vijim *“Ligji”*).

Në vijim, lidhur me pikën 5 dhe 6, të nenit 13 të projektvendimit, ku parashikohen nivelet e aksesit për autoritetet publike, organin procedues, Gjykatën Kushtetuese, përkthyesit/interpretët, Zyra e Komisionerit sugjeron se, përmbajtja e këtyre dy pikave duhet të jetë më e qartë lidhur me kategoritë e të dhënave parësore dhe dytësore që do të kenë akses (lexim) këto autoritete. Theksojmë se, aksesit në secilën kategori të dhënash, nga autoritetet e lartpërmendura, duhet të jetë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, në raport me qëllimin e përpunimit, të sanksionuar në gërmat “b” dhe “c” të nenit 5 të Ligjit.

Njëkohësisht, në këtë nen duhet të parashikohet një pikë më vete ku të sigurohet se, kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara në këtë Regjistër, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit, sipas përcaktimeve të nenit 28 të Ligjit, dhe pikës 6, të Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*.

Me përfshirjen e sugjerimeve të sipërpërmendura, projektvendimi vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

